

Kjo informatë ka të bëj me fëmijët që janë përzgjedhur për arsimin parashkollor dyvjeçar eksperimental, të cilët e kanë pranuar në shtëpin e tyre letrën për këtë eksperimentim.

MIRËSEVINI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR DYVJEÇAR!

**Urime, fëmija i juaj kalon në arsimin parashkollor në vjeshtën që po vjen!
Fëmija i juaj është përzgjedhur në arsimin parashkollor dyvjeçar, pasi që ai është në kopshtin ku organizohet ky eksperimentim apo banoni në afërsi të një kopshti të atillë për fëmijët.**

Fëmijët në arsimin parashkollor njoftohen me gjërat që ju interesojnë duke luajtur dhe duke menduar rreth tyre, ndërsa për fëmijët më të vegjël kjo bëhet në mënyra më të përshtatshme për ata. Qëllimi është, që në arsimin parashkollor fëmijëve të ju hapen mundësia e shoqërimit, e gëzimit nga të mësuarit dhe e interesimit për gjëra të reja. Kohëzgjatja prej dy vjetë, ju jep fëmijëve kohë për edukim dhe mësim sipas mundësive të tyre. Në këtë eksperimentim mblidhen informacione për ndikimin e arsimit parashkollor dyvjeçar te fëmijët në zhvillimin dhe në mësim nxënjen e tyre, në aftësitë e shoqërimit dhe në formimin e vlerësimit të shëndoshë ndaj vetëvetës.

Arsimi parashkollor dyvjeçar është pa pagesë. Organizohet 4 orë në ditë duke respektuar kohën e punës dhe të pushimit në arsimin fillor. Përveçë arsimit parashkollor dyvjeçar, fëmija mund të merr pjesë edhe në edukimin e hershëm plotësues, për të cilin duhet të bëhet pagesa e paraparë për edukimin e hershëm.

Kujdestari i fëmijës duhet të kujdeset, që fëmija të merr pjesë në arsimin parashkollor eksperimental që zgjatë dy vjetë në vendin ku organizohet, apo të kujdeset që të arrij qëllimet e arsimit parashkollor dyvjeçar me mundësi tjera.

Adresa e këtij kopshti për fëmijën, gjendet në letrën e dërguar në shtëpin tuaj.

REGJISTRIMI BËHET KËSHU

Pjesëmarrja në arsimin parashkollor dyvjeçar në kopshtin e fëmijëve ku mbahet ky eksperimentim, kushtëzohet me regjistrimin.

Plotësoje formularin e regjistrimit i shoqëruar me letrën e ardhur dhe ktheje atë në kopshtin që është caktuar për fëmijën tuaj deri në datën 21.5.2021.

Nëse fëmijës tuaj i nevojitet përveçë arsimit parashkollor edhe edukimi i hershëm, dhe fëmija nuk ka qenë në edukimin e hershëm në Vantaa para fillimit të arsimit parashkollor dyvjeçar, ti duhet poashtu me aplikue edhe për edukimin e hershëm për tu plotësuar kushtet e kalimit në arsimin parashkollor. Formulari për edukimin e hershëm mund të plotësohet në internet përmes shërbimit VaSa apo printoje në letër dhe plotësoje formularin për aplikim me letër, në edukimin e hershëm.

Të dhëna shtesë për arsimin parashkollor dyvjeçar si dhe për mundësin e regjistrimit, mund të merren nga kopshtet e fëmijëve si dhe nga drejtuesit e këtyre shërbimeve në zonat ku organizohet edukimi i hershëm.

ÇFARË PRITJESH KE TI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR DYVJEÇAR TË FËMIJËS TËND?

Në Vantaa dëshirojmë të ndëgjojmë mendimet e prindërve, të tregojnë se çka është e rëndësishme për arsimin parashkollor dyvjeçar dhe çfarë pritjesh keni për këtë eksperimentim. Hape faqen Pjesëmarrja në Vantaa në internet nga adresa osallistuvantaa.fi dhe përgjigju në pyetësonin deri në datën 21.5.2021!

STUDIMI I REZULTATEVE TË EKSPERIMENTIT DHE REGJISTRI I EKSPERIMENTIT

Eksperimentimi është i rregulluar me ligj dhe është pjesë e hulumtimit shtetëror (Ministria për Kulturë dhe Arsim). Në hulumtime gjatë analizimit të rezultateve, fëmijët marrin pjesë në vlerësimin e rezultateve dhe prindërit

mund të intervistohen. Vlerësimet individuale të fëmijëve dhe përgjigjëjet e prindërve në pyetësonin e plotësuar nuk raportohen në hulumtimet e tilla dhe se emrat e atyre që janë përgjigjur nuk mund të identifikohen. Edhe nëse fëmija nuk merr pjesë në arsimin parashkollor dyvjeçar në vendin ku bëhet eksperimentimi, të dhënat lidhur me fëmijën ruhen në regjistrin e eksperimentit.

NDIKIMI I ARSIMIT PARASHKOLLOR DYVJEÇAR SI MBËSHTETJE NË PËRKUJDESJEN NDAJ FËMIJËVE

Fëmijët që marrin pjesë në eksperimentim, gëzojnë të drejtat e njejta në përfitimet nga Kela sikurse fëmijët e moshës 6 vjeç, pjesëmarrës në arsimin parashkollor.

Në rastin e mbështetjes për kujdesjen shtëpiake ndaj fëmijës, kjo nënkupton se nëse vëllai ose motra e një fëmije 3 vjeç, merrë pjesë në arsimin parashkollor eksperimental, fëmijës trevjeçar do t'i paguhet paga e plotë e përkujdesjes (65,97 €/muaj). Nëse, vëllai apo motra përveçë arsimit parashkollor eksperimental, merr pjesë edhe në edukimin e hershëm komunal, fëmijës nuk do t'i paguhet mbështetja për përkujdesje shtëpiake. Shembuj të rasteve konkrete:

Matiasi 5 vjeç nga familja Aaltonen është pjesëmarrës në arsimin parashkollor eksperimental. Pas kohës parashkollore (rreth 4 orë në ditë), ai është në përkujdesje shtëpiake me babain dhe motrën 2 vjeçe Anna, për të cilën familja paguhet për kujdesjen shtëpiake ndaj saj dhe me të ashtuquajturën shtesë për fëmijën tjetër.

Pjesëmarrja në arsimin parashkollor nuk ka ndikim në të ardhurat që i paguhen familjes. Sonja 5 vjeçe nga familja Mäkinen, është pjesëmarrëse në mësimin parashkollor eksperimental, por pas mësimit parashkollor ajo vazhdon në edukimin e hershëm plotësues komunal. Nëna e familjes Mäkinen është në shtëpi duke u kujdesur për Maisaan njëvjeçare, për të cilën familja paguhet me mbështetje shtëpiake dhe me të ashtuquajturën shtesë për fëmijën tjetër. Kur Sonja merrë pjesë në edukimin e hershëm plotësues, shtesa për fëmijën tjetër nuk i paguhet.

Eksperimenti nuk ka ndikim në të ardhurat e vazhdueshme apo të pjesërishme për kujdesje ndaj fëmijëve. Pjesëmarrja në arsimin parashkollor dyvjeçar nuk është pengesë për përfitimin e shtesës që paguhet në Vantaa.